



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN

---

Numri i lëndës: 2022:270159

Datë: 23.05.2024

Numri i dokumentit: 05724941

**C.nr.4137/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN, Departamenti i përgjithshëm**, gjyqtari Shaban Shala, me bashkëpunëtoren profesionale D.A. duke vendosur në çështjen juridike të paditësit A.N. nga Prizreni, me numër personal ..... të cilin e përfaqësojnë sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ....” me avokatët e saj: S.K. etj, nga Prishtina, kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren të cilën e përfaqëson Bejtulla Likaj, lidhur më kompensimin e pagave të 13-ta, vlera e kontestit 2,262.04 €, pas dhënies së përgjigjes në padi, më datë 23.05.2024, mori këtë:

**A K T G J Y K I M**

**Pa shqyrtim kryesor të çështjes**

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadia e paditëses A.N. nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar që të **DETYROHET** e paditura Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal në Prizren, që paditëses t’ia bëjë kompensimin e pagave të trembëdhjeta (13) për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 të ia paguajë (kompensojë) shumën prej 2,262.04 Euro me kamatë ligjore prej 8% e cila llogaritet nga data e parashtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës të gjitha këto në afat prej 7 (shtatë) ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjyqimit nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm, **si e pa bazuar.**
- II. Secila pale i bartë shpenzimet e veta procedurale.

**A r s y e t i m**

Paditësja A.N. nga Prizreni, të cilin e përfaqësojnë sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve: Studio Ligjore & Financiare “Klinaku ....” me avokatët e saj: S.K. etj, nga Prishtina, në këtë gjykatë me datë 19.12.2022 kanë parashtruar padi kundër të paditurës Sh.S.K.U.K. – Spitali Rajonal Prizren lidhur më kompensimin e pagave të 13-ta, vlera e kontestit 2,262.04 €.

Të autorizuarit e paditësit në padi kanë theksuar se paditësi është në marrëdhënie pune të rregullt tek e paditura për më tepër se 9 vite. Marrë për bazë dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të datës 12.06.2018 e lidhur në mes palëve Qeveria e Republikës së Kosovës –

Ministria e Shëndetësisë dhe Federata e Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, Ligjit të Punës dhe Kontratës Individuale e paditura nuk e ka bërë kompensimin e pagave të 13-ta për vitet 2019, 2020, 2021 dhe 2022 ashtu siç i takon sipas përvojës së punës. Lartësia e llogaritjes së pagave të 13-ta mbështetet në realizimin e pagës në muajin e fundit të paditësit dhe sipas listës së pagës, paga bazë e paditësit është 565.51 €. Pasi që e paditura nuk e ka përmbushur obligimin e vet, i ka propozuar gjykatës që të aprovojë kërkesëpadinë në tërësi si të bazuar. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar.

E paditura, përmes të autorizuarit të saj, në përgjigjen në padi e ka kontestuar në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit. Gjithashtu ka theksuar se I padituri marrëdhënien e punës në SPZ e ka filluar me 08.10.2018 ku edhe vazhdon të punojë. Duke konsideruar se kërkesëpadia e paditëses është e pabazuar për faktin se bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale neni 17 pika 2 e cila marrëveshje në mënyrë parimore ka rregulluar shumë çështje, kërkesën për kompensimin e pagave të 13-ta e kanë kundërshtuar për faktin se nuk kanë mundësi buxhetore për plotësimin e kësaj kërkeje, për shkak të mjeteve të kufizuara buxhetore. Pra Kontrata Kolektive Sektoriale nuk e obligon punëdhënësin që ta bëjë kompensimin e pagave të 13, por thekson se ky obligim mund të përmbushet në bazë të mundësive buxhetore që i ka punëdhënësi. Gjithashtu kërkesëpadia është e bazuar në Kontratën Kolektive Sektoriale të cilës i ka përfunduar afati kohor me datë 12.06.2021 andaj si e tillë paditëses nuk i takon e drejta për kompensimin e pagave të 13-ta dhe për këtë arsye ka kërkuar që gjykata të merr vendim dhe padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzoj si të pabazuar. Shpenzimet e procedurës kontestimore nuk i ka kërkuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 399 të LPK-së, gjeti se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, andaj pa shqyrtim të çështjes, e refuzoi kërkesëpadinë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Ndërmjet palëve nuk ishte kontestues fakti se paditësja është në marrëdhënie pune te e paditura, respektivisht në Sh.S.K.U.K.- Spitalin Rajonal “Prim. Dr. Daut Mustafa” në Prizren dhe që e njëjta me datë 08.10.2018 ka filluar punën pranë këtij institucioni.

Kontestuese në mes palëve ishte nëse paditësit i takon e drejta për kompensimin e pagës së trembëdhjetë (13).

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, të lidhur në mes të Ministrisë së Shëndetësisë të Republikës së Kosovës dhe Federatës së Sindikatave të Shëndetësisë së Kosovës, e cila ka qenë në fuqi nga data 11.06.2018 deri më datë 10.06.2021. Me nenin 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, është paraparë se “punëmarrësi mund të kompensohet me pagën e trembëdhjetë (13), për çdo vit kalendarik, në vlerën e pagës bazë, sipas mundësive buxhetore të punëdhënësit”.

Pastaj, bazuar në mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, përcaktohet në mënyrë shprehimore se çështja e kompensimit të pagës së trembëdhjetë (13), për punëtorët shëndetësor është e kushtëzuar me mundësitë financiare të punëdhënësit, respektivisht nëse ka mjete buxhetore. Pra, e drejta e punëmarrësit (paditësit) për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13), krijohet kur punëdhënësi (e paditura) nuk e përmbushë atë, ndërsa nuk arrin të provojë se nuk ka pasur mundësi buxhetore. Në fund, është në barrën e punëdhënësit që të provojë çështjen e mundësisë buxhetore, për shpërblimin e një kërkesë të tillë.

Së këndejmi, me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, e paditura në mënyrë konkrete dhe të detajuar ka ilustruar të dhënat se që nga viti 2018 e deri në vitin 2022, nuk ka pasur mundësi buxhetore për të realizuar pagën e trembëdhjetë (13) për punëtorët (paditësin).

Andaj, gjykata vlerëson se dispozita ligjore e nenit 17 par. 2 të Kontratës Kolektive Sektoriale të Shëndetësisë e datës 12.06.2018, nuk është e karakterit detyrues për palët kontraktuese. Kështu, duke u mbështetur edhe në mendimin juridik nr. 212/2023 të datës 09.10.2023, duke qenë se të provuarit e faktit nëse ka mundësi buxhetore i ka takuar të paditurës, e njëjta me njoftimin nr. prot. 3823 të datës 21.12.2023, ka provuar se nuk ka mundësi buxhetore për të kompensuar pagën e trembëdhjetë (13) ndaj paditësit. Kësisoj, gjykata duke vlerësuar bazën ligjore të theksuar më lartë dhe gjendjen faktike të vërtetuar, erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet refuzuar si e pabazuar. Rrjedhimisht, gjykata erdhi në përfundim se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia e paditësit, qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës dhe në bazën juridike konkrete.

Gjykata me rastin e vendosjes jashtë seancës gjyqësore, është bazuar në dispozitën e nenit 399 par. 1 të LPK-së, e cila dispozitë përcakton se “kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do të jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”. Ndërsa në paragrafin 2 të nenit të lartcekur është paraparë se “kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo po që se faktet mbi të cilat mbështetet kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Vendimin që secila palë t’i bartë shpenzimet e procedurës, gjykata e ka mbështetur në nenin 450, 452 dhe 463 të LPK-së. Pra, përkundër faktit se pala paditëse i ka kërkuar shpenzimet procedurale, kërkesëpadia e tij ishte e pabazuar dhe kështu ka humbur kontestin në këtë procedurë gjyqësore. Në anën tjetër, përkundër faktit se e paditura ka fituar kontestin, e njëjta nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në pajtim me nenin 143 të LPK-së lidhur me nenin 399 të LPK-së.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**-Departamenti i përgjithshëm-**

Numri i lëndës: 2022:270159  
Datë: 23.05.2024  
Numri i dokumentit: 05724941

**C.nr.4137/2022, me datë 23.05.2024**

**B. Profesionale  
Delvina Ajazaj**

**Gjyqtari  
Shaban Sh. Shala**

**UDHËZIME PËR ANKESË:** kundër këtij aktgjykimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 7 ditësh, pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate.